

**SHALLJE PËR PRANIMIN, LEVIZJE PARALELE,
PERIUDHEN E PROVES DHE EMERIMIN NË KATEGORINË E EKZEKUTIVE**

Në zbatim të nenit 25 dhe 26 të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreu V – “Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, si dhe planit vjetor të pranimi 2021, Njësia Përgjegjëse e të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, shpall Procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil për pozicionin:

- 1- “Specialist Arkive” 1 (një) në Drejtorinë e Arkives , kategoria e pagës IV-1, pranë ISKK-së.

Pozicioni më sipër, i ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se një pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës për pranim nga jashtë shërbimit civil.

Për keto procedura (lëvizje paralele dhe pranim nga jashtë shërbimit civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e Dokumenteve:	Shih procedurat përkatëse
11.09.2026	Lëvizja paralele
15.09.2026	Pranim nga jashtë shërbimit civil

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Misioni i Drejtorisë:

1. Riprodhon, fotokopjon, ruan, sistemon e katalogon të gjitha dokumentet e materialet, që rezultojnë nga veprimtaria e zhvilluar gjatë periudhës së komunizmit nga organet e diktaturës komuniste, Partia e Punës e Shqipërisë, Fronti Demokratik i Shqipërisë, si dhe

- nga çdo organizatë, institucion apo strukturë tjetër, që zotërojnë dokumente arkivore, të cilat i shërbejnë institutit për studimin e krimeve të komunizmit në Shqipëri;
2. Grumbullon dhe ruan dokumente e materiale arkivore, që kanë lidhje me organet e diktaturës komuniste, të cilat dorëzohen në institut nga qytetarë, organizata të ndryshme, persona fizikë e juridikë, vendas a të huaj;
 3. Publikon dhe siguron aksesin për dokumentet dhe materialet arkivore, që kanë lidhje me organet e diktaturës komuniste, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për përdorimin e tyre;
 4. Siguron akses për dokumente e materiale arkivore. Të japë informacion dhe të asistojë institucionet e organet, që gëzojnë të drejtën e përdorimit/shfrytëzimit të materialeve të sipërpërmendura, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 5. Administron punën me dokumentet dhe materialet arkivore në institut;
 6. Jep vlerësim për ankesat e kërkuesve, që nuk u është dhënë e drejta e aksesit në materialet arkivore, ose nuk janë lejuar të bëjnë përmbledhje, kopje apo transkripte të tyre;
 7. U jep kopje dhe transkripte nga dokumentet/materialet e depozituara në arkiv institucioneve apo organeve publike, qendrore apo të qeverisjes vendore, si dhe personave fizikë a juridikë të autorizuar nga ligji;
 8. Lejon këqyrjen e materialeve arkivore, të depozituara në kushtet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat;
 9. Mirëmban regjistrin e materialeve të arkivuara;
 10. Ruan materialet e aktiviteteve që zhvillon ISKK, foto, video, etj.;
 - a) Për çdo aktivitet hap dosje elektronike në fillim të vitit dhe grumbullon gjithë materialet në formë elektronike, të cilat përbëjnë kujtesën historike të veprimtarisë së ISKK.
 11. Bashkëpunon me arkivat e tjera dhe institucionet shkencore, kulturore e arsimore për shkëmbimin e informacionit dhe të ekspertizës në punën kërkimore dhe në shfrytëzimin/përdorimin e materialeve arkivore, për qëllime kulturore, arsimore, shkencore dhe ekonomike dhe, veçanërisht, për studimin e historisë e të gjeografisë kombëtare;
 12. Krijon një bibliotekë të specializuar në fushën e veprimtarisë së arkivit;
 13. Realizon botime në fushat e veprimtarisë së institutit;
 14. Në bashkëpunim me Arkivin Qendror të Shtetit, siguron ruajtjen dhe restaurimin e materialeve arkivore;
 15. Sistemon e katalogon kujtimet audio-vizuale, apo të shkruara, të ish burgosurve dhe të të persekutuarve politikë;
 16. Organizon workshope, ekspozita, seminare, konferenca, simpoziume;
 17. Trajnon studentë në lidhje me kërkimin arkivor, sistemin, katalogimin, si dhe mënyrën e përdorimit të dokumenteve;
 18. Menaxhon dhe shpërndan botimet e kolanës vjetore të ISKK;
 19. Pasuron fondin e bibliotekës në shërbim të interesave kërkimore të institutit me literaturë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja;
 20. Sistemon e katalogon fondin e Bibliotekës së institutit.

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin konsiston në:

- a) Riprodhon, fotokopjon, ruan, sistemon e katalogon në arkiv dokumente dhe materiale që rezultojnë nga veprimtaria e organeve të diktaturës komuniste të zhvilluar gjatë regjimit komunist.
- b) Pasuron arkivin me dokumente nga institucionet dhe organet e diktaturës komuniste sipas planeve të miratuar nga eprori dhe Drejtori Ekzekutiv.
- c) Regjistron me korrektësi dokumentet e grumbulluara në përputhje me veprimtarinë e Arkivit.

- d) Mirëmban dhe përditëson regjistrin themelor të arkivit.
- e) Ofron asistencë të vazhdueshme në aksesimin e dokumenteve të mbledhura në arkivë.
- f) Përgatit për botim përmbledhje e analiza dokumentare edhe në bashkëpunim me kolegët e drejtorisë dhe të ISKK-së.
- g) Bashkëpunon me kolegët e drejtorisë dhe me kolegët e tjerë të institutit për organizimin e projekteve dokumentare.
- h) Kryen detyra administrative sipas nevojës së institucionit.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda të njëjtës kategori për të cilën aplikon kategoria IV-1 ;
- të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- të ketë të paktën vlerësimin e fundit pozitiv “mirë” apo “shumë mirë”

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimimi:

Diplomë universitare (minimumi Master Profesional) në Arkivistikë, Historí, Bibliotekonomi, Shkenca të Informacionit ose fushë të ngjashme. (diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

Përvoja:

- Preferohet përvojë pune 1–3 vjet në arkivë, biblioteka ose institucione hulumtuese;
- përvojë me dokumente historike/administrative është avantazh.
- Njohuri të standardeve të përshkrimit arkivor metadatas.
- Aftësi teknike për skanim/digjitalizim dhe njohuri të formatit PDF/A/TIFF.
- Njohuri dhe përkushtim ndaj rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dokumenteve me kufizim të qasjes.
- Aftësi komunikimi, organizimi dhe puna me publikun; rigorozitet dhe kujdes në trajtimin e burimeve.

Tjetër:

- a- të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- b- të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së;
- c- njohje e mirë dhe përdorim i lirshëm i kompjuterit dhe programeve bazë.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Sekretarisë të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentet si më poshtë:

- 1) jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lidhjen <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>;
- 2) fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- 3) fotokopje të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- 4) fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 5) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 6) vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- 7) letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- 8) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- 9) në numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- 10) aktin e emërimit si nëpunës civil;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 11.09.2026, në Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit me adresë: Rr. “Saraçevë”, Tiranë.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 14.09.2026, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (Njësia Përgjegjëse) e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, si dhe në faqen zyrtare www.iskk.gov.al listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia Përgjegjëse e institucionit, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 3 (tre) ditëve pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË

ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:\

- Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar .
- Ligji nr. 27, datë 04.04.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, ‘Për arkivat
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10242, datë 25.02.2010 "Për Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit ne Shqipëri ", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9887/2008 për mbrojtjen e të dhënave personale I ndryshuar

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatet do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit i ngritur në ISKK, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është 100 pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) **Kandidatët do të vlerësohen për përvojën**, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.
- b) **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**
 - a- njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b- eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - c- motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al) në lidhjen <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

Komisioni në përfundim të vlerësimit njofton individualisht kandidatët që kanë konkuruar për rezultatin e tyre. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në Komitetin e Përhershëm të Pranimit për rezultatin e vlerësimit, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual

mbi rezultatin. Ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit. Komisioni brenda 24 (njëzetë e katër) orëve pas përfundimit të procedurave të ankimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare www.iskk.gov.al. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

2- PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është pozicion vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës dhe pranim nga jashtë shërbimit civil. Në rast se një vend vakant, nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, atëherë, kanë të drejtë të konkurrojnë edhe kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil.

Këtë informacion do ta merrni në faqen e ISSK-së, pas datës 14/09/2026.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lire dhe/ose kandidate të tjerë nga jashtë shërbimit civil..

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimimi:

- a) a) Diplomë universitare (minimumi Master Profesional) në Arkivistikë, Histori, Bibliotekonomi, Shkenca të Informacionit ose fushë të ngjashme. (*diplomat të cilat janë*

marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

- b) Përbën avantazh eksperiencë e punës në të njëjtin pozicion, me atë të kërkuar;
- c) Të kenë të paktën 3 (tre) vite përvojë pune në profesion (për aplikuesit jashtë sistemit të Shërbimit Civil).

Tjetër:

- të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- 1) jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lidhjen <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>.
- 2) fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) dhe listës së notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- 3) fotokopje të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- 4) fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 5) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 6) vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- 7) letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- 8) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- 9) një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- 10) aktin e emërimit si nëpunës civil;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 15.09.2026, në Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit me adresë: Rr. “Saraçëve”, Tiranë.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil, do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedurë:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen

e ISKK-së pas datës 25//09/2026.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (Njësia Përgjegjëse) e ISKK, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare www.iskk.gov.al listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit (Njësia përgjegjëse), ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit. Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar .
- Ligji nr. 27, datë 04.04.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, ‘Për arkivat
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10242, datë 25.02.2010 "Për Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit ne Shqipëri ", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9887/2008 për mbrojtjen e të dhënave personale I ndryshuar

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatet do të vlerësohen nga Komiteti I Përhershëm Pranimi në ISKK, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është 100 pikë.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al në lidhjen <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare www.iskk.gov.al . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Kandidatët fitues janë ata që renditen të parët nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve). Njësia përgjegjëse njofton individualisht kandidatët që kanë konkurruar për rezultatin e tyre brenda 24 (njëzetekatër) orëve nga dita që komiteti i njofton vendimin e tij. Kandidati ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim në Komitetin e Përhershëm të Pranimi për rezultatin e pikëve brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit , do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare www.iskk.gov.al . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë dhe/ose pranim nga jashtë shërbimit civil, në këtë procedurë, do të marrin informacion për fazat e mëtejshme të kesaj procedure;

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi.

*Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e ISKK-së duke filluar nga data **25.09.2026** e në vijim.*

Njësia Përgjegjëse